



Agjencia e mbikëqyrjes së sigurimeve
Republika e Maqedonisë së Veriut

K O N K U R S

për çmim vjetor për studiuesit e rinj për punë më të mire kerkimore në fushën e menaxhimit të rrezikut dhe të sigurimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2019

Me qëllim për të stimuluar zhvillimin e mendimit shkencor dhe përgaditjen e kërkimeve studimore në fushën e menaxhimit të rrezikut dhe të sigurimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe afirmimin e profesionistëve të rinj, Agjencia për mbikëqyrjen e sigurimeve do të jep çmim vjetor në vitin 2019 për kërkim studimor në fushën e menaxhimit të rrezikut dhe të sigurimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Çmimi vjetor i Agjencisë për mbikëqyrjen e sigurimeve është në vlerë prej 80.000 denarë.

Në kërkimin studimor është i patjetërsueshëm shqyrtimi i ekonomisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me temë adukuatë. Kërkimi studimor nuk duhet të tejkalojë 15.000 fjalë (pa abstrakte, bibliografia dhe anekset) si dhe është rekomanduese që të ketë strukturë standarte të kërkimit studimor, e cila si bazë i përmban pjesët më poshtë:

- Abstraktet;
- Shqyrtimin e literaturës së konsultuar nga fusha e cila hulumtohet;
- Përshkrimin e metodave të kërkimit të përdorura në punën kërkimore;
- Analiza;
- Perceptimet përmblylëse;
- Bibliografia.

Te drejte për të marrë pjesë në konkurs kanë shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në moshë tridhjetë e pesë vjeçe. Të punësuarit dhe anëtarët e Këshillit të ekspertëve të Agjencisë për mbikëqyrjen e sigurimeve nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurs.

Studimet kërkimore dorëzohen në gjuhën maqedone, shqipe ose në gjuhën angleze.

Një autor mund të paraqesë vetëm një studim të pavarur kërkimorë. Studimi kërkimor i punuar si bashkëautor nuk është i pranueshëm.

Në konkurs autorët mund të konkurojnë edhe me studimet kërkimore të botuara gjatë vitit 2019. Në momentin e paraqitjes së studimeve kërkimore, autori duhet të specifikojë se kur dhe ku është botuar studimi kërkimorë.

Konkursi do të konsiderohet i suksesshëm nëse aplikojnë së paku tre(3) studime kërkimore që i përmbushin kushtet e përmendura më lartë.

Studimet kërkimore dorëzohen deri te Agjencia për mbikëqyrjen e sigurimeve me shënim: “Për çmimin vjetor të Agjencisë për mbikëqyrjen e sigurimeve për vitin 2019” nëpërmjet postës elektronike, në adresën: konkurs@aso.mk

Përveç studimit kërkimor, autori duhet të paraqesë të dhëna biografike. Studimet kërkimore të dorëzuara do të trajtohen si materiale konfidenciale.

Zgjedhja më e mirë e studimit kërkimor bëhet nga Komisioni i përbërë nga pesë anëtarë, tre prej të cilëve janë anëtarë të jashtëm. Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit i cakton Këshilli i ekspertëve të Agjencisë për mbikëqyrjen e sigurimeve me vendim i cili do të shpallet në faqen e internetit të Agjencisë për mbikëqyrjen e sigurimeve.

Afati i fundit për dorëzimin e studimeve kërkimore është me datë 30.09.2019.

Çmimi vjetor i Agjencisë për mbikëqyrjen e sigurimeve do të jepet me datë 01.11.2019, me rastin e ditës së themelimit të Agjencisë për mbikëqyrjen e sigurimeve.